




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPKI
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	03
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	06-1657/20
Data Datum Date	13.08.2020



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.08.2020, mori:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPK-06-1171/20*, për zyrtarin e lartë z. Nexhdet Shala, Dekan i Fakultetit të Agrobiznesit, në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-DPK- 06-1171/19, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Nexhdet Shala, Dekan i Fakultetit të Agrobiznesit, në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, është zhvilluar procedura e paraparë për trajtimin e situatave të konfliktit të Interesit.

Ky rast ka filluar të trajtohet sipas detyrës zyrtare pas kontrollit për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, nga ky proces është identifikuar edhe rasti për zyrtarin e lartë publik, respektivisht Dekanin i Fakultetit të Agrobiznesit, në Universitetin “Haxhi Zeka”, në Pejë, i cili figuron të jetë Kryetar dhe person i Autorizuar në Organizatën Joqeveritare SHU-Loxha.

Sipas procedurës Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Departamenti për OJQ, në Ministrinë e Administratës Publike, që të bëjë verifikimin dhe konfirmimin e informacioneve dhe nga përgjigja zyrtare, rezultoi se zyrtari i lartë z.Nexhdet Shala, është Kryetar dhe person i autorizuar në Organizatën Joqeveritare SHU-Loxha.

Pas konfirmimit të informacionit nga ana e Departamenti për OJQ, në Ministrinë e Administratës Publike, në pajtim me nenin 22,paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit nr.06/L-011, Agjencia përmes shkresës zyrtare, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Nexhdet Shala, Dekan i Fakultetit të Agrobiznesit, në Universitetin “Haxhi Zeka”, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të Interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

z. Nexhdet Shala, pas pranimit të kësaj shkrese ka treguar interesim duke kontaktuar zyrtaret e AKK-së, të cilët sipas procedurës e kanë njoftuar atë për iniciimin e rastit dhe i kanë bërë me dije se, gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtari i lartë nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj funksion drejtues dhe as të jetë Përfaqësues i Autorizuar në Organizata Joqeveritare, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, e cila përcaktohet me nenin 13 paragrafi 1,të Ligjit nr.06/L-011, ku thuhet se :

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”,*

si dhe nenin 14 paragrafi 1, i cili përcakton se :

*“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to”.*

Pas këtij komunikimi me zyrtarin e lartë të quajtur ndryshe edhe si ballafaqim i fakteve, zyrtari i lartë z.Nexhdet Shala, është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se OJQ-ja për të cilën bëhet fjalë nuk ka funksionuar në kushte normale dhe nuk ka funksionuar që nga viti 2004, duke mos poseduar as xhirollogari e as ndonjë dokument përcjellës që nga ajo kohë, me gjithë atë do të ndërmerri veprime të menjëhershme në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrim të funksionit publik.

Në ndërkohë, Agjencia ka pranuar njoftimin, informacionin zyrtar nga sistemi i Departamentit për OJQ, më të cilën dëshmohet se Organizatën Joqeveritare “Shoqata e Ujitjes SHU- Loxha.”, është shuar.

Agjencia kundër Korrupsionit, konstaton se me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z.Nexhdet Shala, Dekan i Fakultetit të Agrobiznesit, në Universitetin “Haxhi Zeka”, në Pejë, duke shuar Organizatën Joqeveritare “Shoqata e Ujitjes SHU-Ioxha.”, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

